



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



ZKA

ZYRA KOMBËTARE E AUDITIMIT
NACIONALNA KANCELARIJA REVIZIJE
NATIONAL AUDIT OFFICE

RAPORTI I AUDITIMIT PËR PASQYRAT FINANCIARE VJETORE TË KOMUNËS SË SUHAREKËS PËR VITIN 2025

Raporti i nënshkruar nga

Vlora Spanca,

Auditore e Përgjithshme

Prishtinë, qershor 2026

PËRMBAJTJA E RAPORTIT

- 1 Opinioni i Auditimit
- 2 Gjetjet dhe rekomandimet
- 3 Informacion i përmbledhur për planifikimin dhe realizimin e buxhetit
- 4 Progresi në zbatimin e rekomandimeve

Shtojca I: Letër konfirmimi

Shtojca II: Shpjegim lidhur me llojet e të ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ZKA dhe pjesëve të tjera të Raportit të Auditimit

1 Opinioni i Auditimit

Ne kemi përfunduar auditimin e pasqyrave financiare të Komunës së Suharekës për vitin e përfunduar më 31 Dhjetor 2025, në përputhje me Ligjin për Auditorin e Përgjithshëm dhe Zyrën Kombëtare të Auditimit të Republikës së Kosovës dhe Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Auditimi është kryer për të na mundësuar të shprehim opinionin për pasqyrat financiare dhe konkluzionin për pajtueshmërinë me autoritetet.¹

Opinion i kualifikuar për pasqyrat financiare vjetore

Ne i kemi audituar pasqyrat financiare vjetore të Komunës së Suharekës (KS), të cilat përmbajnë pasqyrën e pranimeve dhe pagesave në para të gatshme, raportin e ekzekutimit të buxhetit si dhe shënimet shpjeguese për pasqyrat financiare, përfshirë përmbledhjen e politikave të rëndësishme të kontabilitetit dhe raportet tjera², për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2025.

Sipas opinionit tonë, përveç ndikimit të çështjes/ve të përshkruara në paragrafin për Bazën për Opinion të Kualifikuar, Pasqyrat Financiare Vjetore të Komunës së Suharekës, prezantojnë një pamje të drejtë dhe të vërtetë në të gjitha aspektet materiale, në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit për Sektorin Publik, sipas kontabilitetit të bazuar në para të gatshme, Ligjin nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë (me plotësime dhe ndryshime) dhe Rregulloren MF, Nr. 01/2017 për raportim vjetor financiar nga organizatat buxhetore.

Baza për Opinion të Kualifikuar

B1 Gjatë vitit 2025, bazuar në vendime gjyqësore Thesari ka ekzekutuar pagesa në vlerë prej 3,082,897€ nga buxheti i Komunës për paga jubilarë dhe shujta, të cilat janë regjistruar në kategori ekonomike joadekuate.

Më gjerësisht shih nënkapitullin 2.1 Çështjet që ndikojnë në opinion të auditimit

Auditimi është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Sipas këtyre standardeve, përgjegjësitë tona janë përshkruar më poshtë tek pjesa e raportit 'Përgjegjësitë e Auditorit për Auditimin e Pasqyrave Financiare'. Në përputhje me ONISA-P-10, SNISA 130, Kodin e Etikës së ZKA-së, si dhe kërkesat e tjera relevante për auditimin e PFV-ve të organizatave buxhetore, ZKA-ja është e pavarur nga subjekti i auditimit. Besojmë se dëshmitë e auditimit që kemi marrë janë të mjaftueshme dhe të duhura për sigurimin e bazës për opinion.

Konkluzion për pajtueshmërinë

Ne kemi audituar nëse proceset dhe transaksionet përcjellëse janë në pajtueshmëri me kriteret e përcaktuara të auditimit që burojnë nga legjislacioni i zbatueshëm për subjektin e audituar në kontekstin e përdorimit të burimeve financiare.

Sipas mendimit tonë, përveç ndikimeve të çështjes/ve të përshkruara në seksionin Baza për Konkluzion të pajtueshmërisë, transaksionet e kryera në procesin e ekzekutimit të buxhetit Komunës së Suharekës kanë qenë, në të gjitha aspektet materiale, në përputhje me kriteret e përcaktuara të auditimit që burojnë nga legjislacioni i zbatueshëm për subjektin e audituar në kontekstin e përdorimit të burimeve financiare.

Baza për konkluzion

- A1 Në tri raste menaxhimi i kontratave nuk ishte bërë përmes platformës elektronike të e-prokurimit.
- A2 Në dy procedura të prokurimit publik, periudha minimale e vlefshmërisë ishte përcaktuar në kundërshtim me kërkesat e Rregullores për Prokurimin Publik.
- A3 Në një rast kemi vërejtur se pozita e rregullt e punës mbahej me ushtrues detyre më gjatë se afati i paraparë ligjor.
- B2 Në 11 pagesa në vlerë totale prej 457,039€, janë bërë ndryshime në shumat e ndara buxhetore të projekteve kapitale pa aprovim të Kuvendit Komunal.
- B3 Në gjashtë raste faturat/obligimet në vlerë prej 119,554.03€ nuk ishin paguar brenda afatit kohorë ligjor prej 30 ditësh.
- B4 Komuna nuk kishte arritur të bëjë inspektimin (verifikimin) për të paktën 20% e të gjitha objekteve brenda territorit të Komunës.
- C1 Në bazën e të dhënave të tatimit në pronë janë identifikuar 238 tatimpagues individual që nuk kanë të prezantuar numrat personal. Megjithatë, veprimet e ndërmarra nga komuna kanë rezultuar në uljen e këtij numri nga viti i kaluar.

Më gjerësisht shih nënkapitullin 2.2 Çështjet që ndikojnë në konkluzionin e pajtueshmërisë

Auditimi është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Sipas këtyre standardeve, përgjegjësitë tona janë përshkruar më poshtë tek pjesa 'Përgjegjësitë e Auditorit për Auditimin e Pasqyrave Financiare'. Në përputhje me ONISA-P-10, SNISA 130, Kodin e Etikës së ZKA-së, si dhe kërkesat e tjera relevante për auditimin e PFV-ve të organizatave buxhetore, ZKA-ja është e pavarur nga subjekti i auditimit. Besojmë se dëshmitë e auditimit që kemi marrë janë të mjaftueshme dhe të duhura për sigurimin e bazës për konkluzion.

Përgjegjësitë e Menaxhmentit dhe të organeve drejtuese/qeverisëse për pasqyrat financiare vjetore

Kryetari i Komunës është përgjegjës për përgatitjen dhe prezantimin e drejtë të Pasqyrave Financiare sipas Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit në Sektorin Publik - Raportimi Financiar bazuar në Kontabilitetin e Parasë së Gatshme. Po ashtu, Kryetari i Komunës është përgjegjës edhe për vendosjen e kontrolleve të brendshme, të cilat i përcakton si të nevojshme për të mundësuar përgatitjen e Pasqyrave Financiare, pa keq deklarime materiale të shkaktuara, qoftë nga mashtrimi apo gabimi. Kjo përfshinë përmbushjen e kërkesave që burojnë nga Ligji nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë dhe Rregullorja nr. 01/2017 për Raportim Vjetor Financiar nga Organizata Buxhetore.

Kryetari i Komunës është përgjegjës për të siguruar mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të Komunës së Suharekës.

Përgjegjësia e Menaxhmentit për Pajtueshmërinë

Menaxhmenti i Komunës së Suharekës është gjithashtu përgjegjës për përdorimin e burimeve financiare të Komunës së Suharekës në përputhje me Ligjin për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësinë dhe të gjitha rregullat dhe rregulloret e tjera të zbatueshme.³

Përgjegjësia e Auditorit të Përgjithshëm për auditimin e PFV-ve

Objektivat tona janë të ofrojmë siguri të arsyeshme nëse pasqyrat financiare si tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit dhe të hartojmë një raport të auditimit që përfshin opinionin tonë. Siguria e arsyeshme është siguri e nivelit të lartë, por nuk është një garanci se një auditim i kryer në përputhje me SNISA-t do të zbulojë çdo keq-deklarim material që mund të ekzistojë. Keq-deklarimet mund të vijnë nga mashtrimi ose gabimi dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht ose si tërësi, në mënyrë të arsyeshme pritet të ndikojnë në vendimet ekonomike të përdoruesve të marra në bazë të këtyre pasqyrave financiare.

Objektivi ynë është gjithashtu të shprehim një konkluzion të auditimit për pajtueshmërinë e autoriteteve përkatëse të Komunës së Suharekës me kriteret e përcaktuara të auditimit që burojnë nga legjislacioni i zbatueshëm në kontekstin e përdorimit të burimeve financiare, lidhur me subjektin e audituar.

Si pjesë e auditimit në përputhje me Ligjin për ZKA dhe SNISA-të, ne ushtrojmë gjykim dhe skepticism profesional gjatë gjithë auditimit. Ne gjithashtu:

- Identifikojmë dhe vlerësojmë rreziqet e keq-deklarimit material të pasqyrave financiare, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit, hartojmë dhe kryejmë procedurat e auditimit që i përgjigjen atyre rreziqeve, dhe marrim dëshmi të auditimit që janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të siguruar bazën për opinionin. Rreziku i mos zbulimit të një keq-deklarimi material që rezulton nga mashtrimi është më i lartë sesa për atë që rezulton nga gabimi, pasi mashtrimi mund të përfshijë manipulim, falsifikim, lëshime të qëllimshme, keq përfaqësime ose anashkalim të kontrolleve të brendshme.

- Identifikojmë dhe vlerësojmë rreziqet e mos-pajtueshmërisë me autoritetet, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit, hartojmë dhe kryejmë procedurat e auditimit që janë përgjegjëse ndaj atyre rreziqeve, dhe marrim dëshmi të auditimit që janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të siguruar bazën për konkluzionin tonë për pajtueshmërinë me autoritetet. Rreziku i mos zbulimit të një rasti të mos pajtueshmërisë me autoritetet që vjen nga mashtrimi është më i lartë sesa për atë që rezulton nga gabimi, pasi mashtrimi mund të përfshijë manipulim, falsifikim, lëshime të qëllimshme, keq përfaqësime ose anashkalim të kontrollit të brendshëm.
- Sigurohemi ta kuptojmë kontrollin e brendshëm relevant për auditimin, për t'i hartuar procedurat e auditimit që janë të përshtatshme, por jo me qëllim të shprehjes së një opinioni mbi efektivitetin e kontrollit të brendshëm të Komunës së Suharekës.
- Vlerësojmë përshtatshmërinë e politikave të kontabilitetit të përdorura dhe arsyeshmërinë e vlerësimeve të kontabilitetit dhe shpalosjet e ndërlydhura të bëra nga menaxhmenti.
- Vlerësojmë prezantimin e përgjithshëm, strukturën dhe përmbajtjen e pasqyrave financiare, përfshirë shpalosjet, për t'u siguruar se pasqyrat financiare paraqesin transaksionet dhe ngjarjet themelore në mënyrë të drejtë dhe të saktë.

Ndër të tjera, ne komunikojmë me menaxhmentin dhe ata që janë përgjegjës për qeverisjen edhe në lidhje me fushëveprimin dhe kohën e planifikuar të auditimit dhe gjetjet e rëndësishme të auditimit, përfshirë ndonjë mangësi domethënëse në kontrollin e brendshëm që ne e identifikojmë gjatë auditimit.

Nga çështjet e komunikuar me menaxhmentin, ne përcaktojmë ato çështje që ishin më të rëndësishme në auditimin e Pasqyrave Financiare të periudhës aktuale dhe që cilësohen si çështje kyçe të auditimit. Raporti i auditimit publikohet në ueb faqen e ZKA-së, me përjashtim të informacioneve që klasifikohen si senzitive apo për shkak të ndalesave të tjera ligjore e administrative, në pajtim me legjislacionin në fuqi.

2 Gjetjet dhe rekomandimet⁴

Gjatë auditimit, kemi vërejtur fusha ku nevojiten përmirësime të dukshme, rreth menaxhimit financiar dhe kontrollit.

Komuna e Suharekës në vitin 2025, ka shpenzuar 24,707,488€ apo 97% të buxhetit final. Dobësi e evidentuara në fusha të caktuara janë: keq klasifikimi i shpenzimeve, ndryshimet në shumat e ndara buxhetore për projektet kapitale pa aprovim të Kuvendit Komunal, mangësi në menaxhimin e llogarive të arkëtueshme, mos verifikimi i pronave, mos regjistrimi i pasurisë, mangësi në prokurim, vonesa në pagesën e faturave, të cilat janë paraqitur më poshtë për shqyrtimin tuaj në formë të gjetjeve dhe rekomandimeve.

Këto gjetje dhe rekomandime kanë për qëllim të bëjnë korrigjimin e nevojshëm të informacionit financiar të paraqitur në pasqyrat financiare, duke përfshirë shpalosjet në formë të shënimeve shpjeguese dhe të përmirësojnë kontrollet e brendshme lidhur me raportimin financiar dhe pajtueshmërinë me autoritetet në lidhje me menaxhimin e fondeve të sektorit publik.

Vlenë të theksohet se gjatë vitit 2025, ishin realizuar pagesa nga Thesari, në bazë të vendimeve gjyqësore/përmbartimore në vlerë 3,082,897€ për kontratën kolektive.

Ky raport ka rezultuar me 13 rekomandime, prej tyre pesë janë rekomandime të reja, shtatë të përsëritura dhe një pjesërisht i përsëritur.

Derisa për statusin e rekomandimeve të vitit paraprak dhe nivelin e zbatimit të tyre, shih kapitullin 4.

2.1 Çështjet që ndikojnë në opinionin e auditimit

Çështja B1 - Klasifikimi jo adekuat i shpenzimeve

Gjetja

Rregulla financiare Nr. 01/2013/MF - Shpenzimi i Parave Publike, neni 18, pika 3 përcakton se shpenzimet duhet të kenë kodet adekuate, të përcaktuara me Udhëzimin Administrativ për planin kontabël. Po ashtu, me planin kontabël të thesarit janë përcaktuar kodet dhe kategoritë përkatëse të shpenzimeve që OB-të duhet të aplikojnë.

Gjatë vitit 2025, bazuar në vendime gjyqësore Thesari ka ekzekutuar pagesa në vlerë prej 3,082,897€ nga buxheti i Komunës për paga jubilarë dhe shujta, të cilat janë regjistruar në kategori ekonomike jo adekuate. Prej tyre nga investimet kapitale ishin realizuar 2,142,028€, nga mallrat dhe shërbimet 794,018€, si dhe nga subvencionet 146,851€.

Vlen të theksohet se komuna nuk kishte përcaktuar saktësisht se sa është vlera e shpenzimeve që i përkasin borxhit kryesor për paga dhe sa e atyre përmbartimore (interes, ekspertizë, etj.).

Pagesat për paga jubilarë dhe shujta kanë ndodhur si rezultat i kontratës kolektive, shpenzimet e të cilave nuk janë planifikuar në buxhet. Megjithatë, këto pagesa janë ekzekutuar nga thesari.

Ndikimi

Pagesat e kryera nga kategoritë jo adekuate të shpenzimeve ndikojnë në raportim financiar jo të drejtë, si dhe në mbivlerësimin /nënvlerësimin e kategorive të shpenzimeve.

Rekomandimi B1

Kryetari duhet të vazhdoj përpjekjet në bashkëpunim me Ministrinë e Financave për të zgjidhur çështjen e planifikimit dhe realizimit të shpenzimeve për kontratën kolektive në mënyrë që pagesa dhe regjistrimi i shpenzimeve të bëhet sipas kodeve ekonomike adekuate të përcaktuara me plan kontabël, për të mundur raportim të drejtë të tyre në PVF.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

2.2 Çështjet që ndikojnë në konkluzionin e pajtueshmërisë

Çështja A1 - Dobësi në menaxhimin e kontratave përmes platformës elektronike të e-prokurimit

Gjetja Rregullorja Nr. 01/2022 për Prokurimin Publik, neni 70.2 parasheh se vlerësimi i performancës së kontraktuesve do të bëhet në sistem të prokurimit elektronik nga menaxherët e kontratës nëpërmjet të modulit për vlerësim të performancës së kontraktuesve, gjatë dhe me përfundim të implementimit të kontratave publike dhe kontratave kornizë. Si dhe neni 73.1 Autoritetet kontraktuese nëpërmjet menaxhereve të kontratës dhe sistemit të prokurimit elektronik do të mirëmbajnë një përmbledhje të shënimeve të menaxhimit të kontratës lidhur me çdo procedurë prokurimi.

Nga mostrat e testuara ne kemi vërejtur se, në tri raste me vlerë totale të kontratave 938,140€ menaxherët e kontratave nuk kishin bërë vlerësimin e performancës së kontraktuesve përmes sistemit elektronik të prokurimit publik gjatë apo pas përfundimit të implementimit të kontratës. Ndërsa vetëm në njërin rast kontrata me vlerë të 875,960€, menaxheri i kontratës kishte evidentuar në raportin për monitorim të kontratave, dorëzimet, pagesat/faturat që lidhen me implementim të kontratës.

Kjo kishte ndodhur si rezultat i kontroleve të brendshme jo efikase në procesin e menaxhimit të kontratave përmes platformës elektronike të e-prokurimit.

Ndikimi Mos mbajtja dhe arkivimi i kontratave përmes sistemit të prokurimit publik, mund të ndikoj në një menaxhim jo të mirëfilltë të kontratave, si dhe nuk ofron mundësi e mjaftueshme që menaxhmenti apo përdoruesit e lejuar të marrin informata me kohë reale në lidhje me progresin dhe menaxhimin/performancën e kontratave.

Rekomandimi A1 Kryetari duhet të sigurojë që të gjithë menaxherët e kontratave/projekteve, aplikojnë menaxhimin e kontratave dhe vlerësimin e performancës së operatorëve ekonomik/kontraktuesve përmes sistemit elektronik të prokurimit publik.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

Çështja A2 - Vlefshmëria e tenderit në kundërrshtim me rregulloren e prokurimit publik.

Gjetja Sipas Rregullore Nr. 001/2022 për Prokurimin Publik, përkatësisht nenit 30, autoritetet kontraktuese janë të obliguara që në dosjen e tenderit të përcaktojnë qartë periudhën e vlefshmërisë së tenderit, e cila duhet të specifikohet si numër i ditëve kalendarike duke filluar nga afati i fundit për dorëzimin e tenderëve.

Po ashtu, periudha minimale e vlefshmërisë së tenderit duhet të jetë në përputhje me vlerën e kontratës, si në vijim:

- së paku 90 ditë për kontrata me vlerë të madhe;
- së paku 60 ditë për kontrata me vlerë të mesme; dhe
- së paku 30 ditë për kontrata me vlerë të vogël.

Në dy procedura të prokurimit publik, në dosjen e tenderit dhe në njoftimin

për kontratë, te pika IV.3.5 “Periudha e vlefshmërisë së tenderit”, është përcaktuar periudha prej 30 ditësh në kundërshtim me kërkesat e Rregullores për Prokurimin Publik ku kërkohet 60 ditë. Kjo ka ndodhur tek procedura e prokurimit:

- “Ndërtimi i impiantit për ujëra të zeza në Dubravë”, vlera e parashikuar e kontratës 190,000€; si dhe
- “Ndërtimin dhe rikonstruimin e kanalizimeve në Komunën e Suharekës” vlera e parashikuar e kontratës 400,000€.

Kjo ka ndodhur si rezultat i mungesës së kontrollit dhe verifikimit adekuat gjatë përgatitjes së njoftimit për kontratë.

Ndikimi

Përcaktimi i një periudhe më të shkurtër se minimumi i kërkuar nuk është në përputhje me kërkesat ligjore dhe mund të ndikojë në rregullsinë e procesit të prokurimit.

Rekomandimi A2

Kryetari duhet të sigurojë që në proceset e prokurimit periudha e vlefshmërisë së tenderit të jetë në përputhje me kërkesat ligjore, duke aplikuar minimumin e përcaktuar sipas vlerës së kontratës, në mënyrë që të sigurohet ligjshmëria e procedurës së prokurimit.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

Çështja A3 - Tejkallim i afateve të parapara ligjore si ushtrues i detyrës

Gjetja

Sipas Neni 35 të Ligjit Nr. 08/L-197 për Zyrtarët Publik, i ndryshuar me Ligjin Nr. 08/L-294, një zyrtar publik nuk mund të caktohet si ushtrues detyre më gjatë se 12 muaj, përveç rasteve kur procedura e rekrutimit është shpallur por pozita nuk është plotësuar për arsye objektive. Po ashtu, pozita e lirë nuk mund të zëvendësohet me ushtrues detyre për më gjatë se dy vite.

Komuna e Suharekës, përkatësisht Drejtoria e Arsimit mban një pozitë të rregullt të punës me ushtrues detyre më gjatë se afati i paraparë ligjor prej 12 muajve duke kaluar periudhen prej dy viteve.

Kjo ka ndodhur si rezultat i dështimit të procedurave të rregullta dhe kujdesi jo i duhur për të siguruar që të mos kalohen periudhat ligjore prej dy vitesh të mbajtjes së pozitave me UD.

Ndikimi

Mbajtja e pozitave me ushtrues detyre për një kohë më të gjatë se afati i paraparë ligjor është në kundërshtim me kërkesat ligjore dhe rrezikon që pozitat të mbahen nga persona që nuk i përmbushin kriteret e kërkuara/përcaktuara për pozitat adekuate.

Rekomandimi A3

Kryetari duhet të sigurojë respektimin e afateve ligjore të përcaktuara me ligj për caktimin e zyrtarëve në pozita të rregullta si ushtrues detyre, duke ndërmarrë veprimet për fillimin dhe përfundimin e procedurave të rekrutimit.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

Çështja B2 - Ndryshimet në shumat e ndara buxhetore të projekteve kapitale pa aprovim të Kuvendit Komunal

Gjetja Neni 16 paragrafi 11 i Ligjit Nr. 08/L-332 mbi ndarjet buxhetore për buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2025 parasheh se "Ndryshimet në shumat e ndara buxhetore për projektet ekzistuese si rezultat i transfereve dhe/ose rialokimeve, të prezantuara në tabelën 4.2, duke përfshirë edhe të hyrat vetanake të bartura, si dhe të regjistruara në SIMFK, duhet të aprovohen paraprakisht nga Kuvendi Komunal".

Në 11 pagesa të investimeve kapitale, në vlerë totale prej 457,039€, fondet ishin marrë nga projekte tjera të aprovuara në ligjin e buxhetit. Fondet janë paguar pasi që ato janë lejuar me aktvendime nga Kryetari i Komunës për bartje nga një projekt në projektin tjetër sipas kërkesës së drejtorisë përkatëse. Megjithatë, këto ndryshime në ndarjet buxhetore janë bërë pa miratimin e Kuvendit Komunal, siç kërkohet me legjislacionin në fuqi.

Kjo kishte ndodhur për shkak të mungesës së mjeteve buxhetore pasi që Ministria e Financave me vendime përmbarimore i kishte paguar obligimet e dala nga kontrata kolektive në arsim për shujta, kualifikime dhe transport nga buxheti i planifikuar për projektet në fjalë.

Ndikimi Ndryshimet në shumat buxhetore pa aprovim të Kuvendit Komunal, mund të reduktojnë transparencën dhe llogaridhënien në vendimet e marra rreth shfrytëzimit të fondeve publike. Këto, po ashtu mund të kenë ndikim negative në implementimin e projekteve ekzistuese duke pamundësuar financimin e mjaftueshëm për to.

Rekomandimi B2 Kryetari duhet të sigurojë, se për çdo ndryshim në shumat buxhetore të projekteve të aprovuara në ligjin e buxhetit, të marrë paraprakisht aprovimin nga Kuvendi Komunal.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)**Çështja B3 - Vonesa në pagesën e obligimeve financiare**

Gjetja Sipas Ligjit për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë (LMFPP), Nr. 03/L-048, neni 39 përcakton se Zyrtari Kryesor Financiar (ZKF) i Organizatës Buxhetore është përgjegjës për të siguruar që çdo faturë e vlefshme dhe kërkesë për pagesë për mallrat dhe shërbimet e furnizuara dhe/ose punët e realizuara për Organizatën Buxhetore të paguhen brenda 30 ditëve kalendarike nga pranimi i faturës ose kërkesës për pagesë.

Në gjashtë raste faturat/obligimet në vlerë prej 119,554€ nuk ishin paguar brenda afatit ligjorë prej 30 ditësh. Vonesat në pagesa ishin nga 62 deri në 258 ditë përtej afatit ligjorë.

Kjo ka ndodhur si rezultat i kontrolleve jo adekuate në ekzekutimin e pagesave dhe menaxhimin e kontratave publike si dhe mungesës së buxhetit për shkak të shpenzimeve të kryera përmes vendimeve gjyqësore.

Ndikimi Vonesat në pagesën e faturave rrisin rrezikun për kosto shtesë si rezultat i

padive apo kërkesave nga furnitorët dhe vështirësojnë menaxhimin efektiv të kontratave.

Rekomandimi B3 Kryetari duhet të siguroj se hyrja në obligime bëhet vetëm pasi mjetet buxhetore të jenë zotuar paraprakisht, si dhe obligimet financiare ndaj kontraktuesve të paguhën brenda 30 ditëve nga data e pranimit të faturave në mënyrë që të shmangen pagesat shtesë të interesit nga vendimet gjyqësore/përmbarimore.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

Çështja B4 - Mangësi në inspektimin e objekteve komunale

Gjetja Neni 15 i Ligjit Nr.06/L-005 për Tatimin në Pronën e Paluajtshme, paragrafi 2 parasheh “Veprimtaritë inspektuese kryhen çdo vit për të paktën njëzetë përqind (20%) të të gjitha objekteve brenda territorit të Komunës dhe vetëm kur është e nevojshme për parcelat”. Poashtu paragrafi 1 i këtij neni parasheh “Komuna inspekton pronat e paluajtshme brenda territorit të Komunës. Komuna mund të angazhojë inspektor privat për të ndihmuar në veprimtaritë inspektuese”.

Gjatë vitit 2025, Komuna nuk kishte arritur të përmbushë kuotën ligjore për të paktën 20% për inspektim të të gjitha objekteve-parcelave brenda territorit të Komunës. Nga gjithsej 17,818 prona, anketuesit kishin arritur të inspektonin 490 objekte-parcela apo vetëm 2.75%.

Sipas konfirmimit të zyrtarit përgjegjës të tatimit në pronë, mos përmbushja e obligimit ligjor për verifikimin e 20% të objekteve respektivisht parcelave kishte ndodhur si rrjedhojë e mos funksionimit të sistemit të tatimit në pronë, mungesës së stafit për kryerjen e inspektimeve dhe sfidave në teren për të marr informatat nga pronarët e objekteve.

Ndikimi Mos arritja e inspektimit të 20% të objekteve mund të rezultojë në ngarkesë të mbivlerësuar apo nënvlerësuar tatimore për tatimpaguesit.

Rekomandimi B4 Kryetari duhet të sigurojë arritjen e verifikimit të 20% të pronave të paluajtshme, në mënyrë që ndryshimet eventuale të pronave të integrohen në bazën e të dhënave për të reflektuar detyrimin e saktë tatimor.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

Çështja C1 - Mangësi në bazën e të dhënave të tatimpaguesve në pronë

Gjetja Neni 12 i Ligjit Nr.06/L-005 për Tatimin në Pronën e Paluajtshme, thekson se komuna ka përgjegjësi për regjistrim dhe menaxhim të të dhënave të tatimit në pronë në regjistrat e tatimit në pronë ashtu siç përcaktohet në aktin nënligjor. Përveç kësaj, Ministria e Financave përkatësisht Departamenti i Tatimit në Pronë, ka njoftuar komunat për vendimin e marrë për regjistrimin e numrit personal në rastin e zbatimit të nenit 11 të Ligjit nr. 06/L-005, me qëllim të shmangies së dyfishimeve/apo parregullsisve dhe sigurimin e zbatimit efektiv të këtij neni.

Gjatë analizës së bazës së të dhënave të tatimit në pronë është identifikuar se 238 tatimpagues individual nuk kanë të prezantuar numrat personal në

këtë bazë. Megjithatë, veprimet e ndërmarra nga komuna kanë rezultuar në uljen e këtij numri nga viti i kaluar, ku numri i tyre ishte 1,309.

Kjo ka ndodhur si rrjedhojë e aplikimit të tatimit në tokat bujqësore dhe pamundësisë për të azhurnuar shënimet në sistemin e tatimit, për shkak të mos funksionimit të rregullt të programit të tatimit në pronë gjatë vitit 2025.

Ndikimi

Mungesa e të dhënave për numrat personalë identifikues të tatimpaguesve në bazën e të dhënave paraqet një mangësi dhe rrit rrezikun e përfitimeve të padrejta, duke mundësuar që disa tatimpagues të përfitojnë në mënyrë të paautorizuar nga zbritja e lejuar për vendbanimin parësor.

Rekomandimi C1

Kryetari duhet të ndërmerr veprimet e nevojshme për të siguruar që baza e të dhënave të tatimit në pronë plotësohet me të gjithë numrat personal të tatimpaguesve.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

2.3 Çështjet tjera të menaxhimit financiar dhe të pajtueshmërisë

2.3.1 Të hyrat

Të hyrat vetjake të planifikuara për vitin 2025 ishin 2,401,424€, përderisa ishin realizuar 2,273,244€. Ato kanë të bëjnë me të hyrat nga tatimi në pronë, të hyrat nga lejet e ndërtimit, taksat administrative, të hyrat nga veprimtaritë biznesore, të hyrat nga qiraja etj. Po ashtu, komuna për vitin 2025, ka pranuar të hyra nga gjobat nga trafiku, gjobat e gjykatës dhe të hyrat nga agjencioni i pyjeve në vlerë totale prej 731,000€.

Çështja B5 - Mangësi në raportimin e rregullt për shfrytëzim të pronave komunale

Gjetja	<p>Neni 22 paragrafi 2 i Ligjit nr. 06/L-092 për dhënien në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të komunës, përcakton se: Kryetari i Komunës obligohet që në raportet e tij të rregullta gjashtë mujore t'i paraqet Kuvendit të Komunës edhe raportimin e veçantë për monitorimin e realizimit të kontratave dhe përmbushjes së qëllimit të dhënies në shfrytëzim të pronave të paluajtshme, deri në fillimin e implementimit dhe arritjes së qëllimit të dhënies së pronës në shfrytëzim.</p> <p>Kryetari kishte përgatitur raporte të rregullta gjashtë mujore, mirëpo këto raporte nuk përmbanin informata lidhur me monitorimin e realizimit të kontratave që kanë të bëjnë me dhënien në shfrytëzim të pronave komunale.</p> <p>Kjo vjen si rezultat i kontrolleve të brendshme jo efektive dhe mungesës së formimit të komisionit për mbikëqyrje për të zbatuar kërkesat ligjore në lidhje me monitorimin e realizimit të kontratave dhe përmbushjes së qëllimit të dhënies në shfrytëzim të pronave të paluajtshme.</p>
Ndikimi	Mungesa e informatave mbi monitorimin e realizimit të kontratave të dhëna në shfrytëzim të pronave të paluajtshme, kufizon transparencën dhe mbikëqyrjen efektive të menaxhimit të pronave komunale.
Rekomandimi B5	Kryetari duhet të sigurojë se raportet rregullta gjashtë mujore të përmbajnë edhe raportimin e veçantë për monitorimin e realizimit të kontratave dhe përmbushjes së qëllimit të dhënies në shfrytëzim të pronave të paluajtshme.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

2.3.2 Pagat dhe mëditjet

Buxheti final për paga dhe mëditje në vitin 2025 ishte 12,647,612€, nga i cili janë realizuar shpenzime në vlerë 12,647,156€.

Çështja A4 - Mos nxjerrja e rregulloreve te brendshme ne përputhje me dispozitat ligjore

- Gjetja** Neni 34, i Rregullores (QRK) Nr. 06/2024 për klasifikimin e vendeve të punës në shërbimin civil përcakton se: "Obligohen institucionet në fushën e veprimit të kësaj Rregulloreje të përgatisin klasifikimin dhe grupimin e pozitave të punës në pajtim me këtë Rregullore dhe katalogun e vendeve të punës, jo më vonë se tre (3) muaj nga hyrja në fuqi e kësaj Rregulloreje.
- Komuna kishte nxjerrë Vendim për organizimin e brendshëm dhe sistematizimin e vendeve të punës por ende nuk kishte hartuar rregulloren përkatëse sipas kërkesës së legjislationit në fuqi.
- Mos nxjerrja e kësaj rregulloreje është rezultat i mungesës së funksionimit efektiv të sistemit të kontrollit të brendshëm.
- Ndikimi** Mos hartimi i rregullores për klasifikimin dhe grupimin e pozitave të punës në përputhje me dispozitat ligjore mund të krijoj vonesa në realizimin e kërkesave të parashikuara nga kjo rregullore. Këto vonesa mund të ndikojnë në funksionimin dhe zbatimin e politikave në përputhje me ndryshimet ligjore, duke krijuar pasiguri në menaxhimin dhe zbatimin e proceseve administrative.
- Rekomandimi A4** Kryetari duhet të siguroj që të përshpejtohet procesi i hartimit dhe miratimit të rregullores për klasifikimin dhe grupimin e pozitave të punës, në mënyrë që të respektohen kërkesat e afateve të përcaktuara sipas rregullores në fuqi.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

2.3.3 Pasuritë kapitale dhe jokatitale

Vlera e paraqitur në PFV e pasurive kapitale është 292,766,982€, pasurive jokatitale është 799,499€, si dhe e stoqeve 55,823€.

Çështja B6 - Mosregjistrimi i pasurive jo kapitale në sistemin e e-pasurisë

- Gjetja** Rregullorja MF-NR. 02/2013 për menaxhimin e pasurisë jo financiare në organizatat buxhetore, neni 6.3. përcakton se, “Pasuria kapitale duhet të regjistrohet në SIMFK ndërsa pasuria jo kapitale dhe stoqet duhet të regjistrohet në sistemin “e-pasuria”.
- Në shtatë raste në vlerë prej 7,732€, pasuritë jo kapitale nën 1,000€ nga drejtoria e arsimit dhe shëndetësisë nuk ishin regjistruar në sistemin e e-pasurisë.
- Mos regjistrimi i pasurisë jo kapitale në sistemin e e-pasurisë ka ndodhur për shkak të mosfunksionimit të duhur të kontrolleve të brendshme.
- Ndikimi** Mos regjistrimi i të gjitha pasurive jokatitale nën 1,000€, në regjistrin e e-pasurisë ndikon në nënvlerësim të pasurisë dhe raportim të pasaktë të pasurive jokatitale në pasqyrat financiare.
- Rekomandimi B6** Kryetari duhet të shtojë kontrollet e brendshme për tu siguruar regjistrimin e pasurisë nën 1,000€, në regjistrat kontabël të e-pasurive.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

2.3.4 Të arkëtueshmet

Në PVF për vitin 2025, Komuna ka shpalosur llogari të arkëtueshme në vlerë totale prej 8,604,389€. Kjo vlerë përbëhet nga të arkëtueshmet e tatimit në pronë në vlerë 4,921,218€, taksat në biznes për ushtrim të veprimtarisë të pa arkëtuara në vlerë 3,009,749€, të arkëtueshmet nga renta për shfrytëzim të hapësirës publike në vlerë 288,181€ si dhe të arkëtueshmet nga qiraja në vlerë 385,241€. Në krahasim me vitin paraprak, L/A në vitin 2025 janë rritur për 502,126€ apo 6.20%.

Çështja B7 - Mungesë e veprimeve për arkëtimin e llogarive të arkëtueshme

Gjetja Neni 26 i Ligjit Nr. 06/L-005 për Tatimin në Pronën e Paluajtshme, përcakton se “Komuna, Ministria e Financave dhe organet kompetente përmbaruese kanë autoritetin dhe kompetencat për të mbledhur detyrimet tatimore të papaguara që kalojnë shumën e dhjetë (10) Eurove”. Tutje, Ligji Nr. 08/L-244 për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit Nr.06/L-055 për tatimin në pronën e paluajtshme, neni 6 specifikon se për vitin tatimor 2024 dhe vitet tatimore pasuese, detyrimi tatimor për personat jo-rezidentë mund të paguhet në një kësht të vetëm, më së largu në datën 30 shtator të vitit tatimor përkatës. Po ashtu, Rregullorja për taksa, tarifa dhe gjoha komunale në Komunën e Suharekës, neni 5 specifikon se të gjitha pagesat e taksave komunale bëhen sipas shumave të përcaktuara në këtë rregullore, ndërsa në faturim janë specifikuar afatet kohore për arkëtim.

Gjatë testimit të mostrave për llogaritë e arkëtueshme, kemi identifikuar se në 47 raste të papaguara për tatimin në pronë në vlerë 199,017€, si dhe dy raste të papaguara në vlerë 1,900€ për taksën në biznes për ushtrim të veprimtarisë, komuna nuk ka ndërmarrë veprimet e kërkuara për inkasim e tyre, përkundër faktit se këto llogari janë bartur ndër vite.

Dobësitë e identikuara lidhur me llogaritë e arkëtueshme janë për shkak të kontrolleve të brendshme jo efikase në menaxhimin përkatësisht arkëtimin e tyre.

Ndikimi Mos arkëtimi në kohë i të hyrave dhe mungesa e marrjes së veprimeve të kërkuara sipas ligjit për inkasimin e tyre ka efekt negativ në financimin dhe realizimin e projekteve nga të hyrat vetanake. Gjithashtu, vjetërsia e të arkëtueshmeve e vështirëson dhe pamundëson mbledhjen e tyre.

Rekomandimi B7 Kryetari duhet të sigurojë forcimin e kontrollit të brendshëm për menaxhimin e të arkëtueshmeve, si dhe rritjen e efikasitetit për arkëtimin e tyre. Po ashtu të analizohen shkaktarët e rritjes së të arkëtueshmeve si dhe të krijojë strategji të mbledhjes së tyre, përfshirë dhe ndërmarrjen e veprimeve ligjore për inkasimin e tyre.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

Çështja A5 - Mos-përputhje ndërmjet llogarive të arkëtueshme dhe faturave të tatimit në pronë

Gjetja Sipas Nenit 21, paragrafi 5, pika 5.15 i Ligjit Nr. 06/L-005 për Tatimin në Pronën e Palujtshme, faturat duhet të përmbajnë shumën totale të tatimit të papaguar për çdo vit tatimor të mëparshëm. Neni 16 i Rregullores MF - Nr. 01/2017 për raportim vjetor financiar nga organizatat buxhetore përcakton se: "Organizatat buxhetore që mbledhin të hyra janë të detyruara të mbajnë regjistra të të hyrave të mbledhura dhe shumave të faturuara e të pa arkëtuara".

Gjatë auditimit janë identifikuar 45 raste ku vlera e borxhit e paraqitur në faturat e tatimit në pronë nuk përputhet me vlerën e paraqitur në llogaritë e arkëtueshme në Pasqyrat Financiare Vjetore (PFV). Në 44 raste, vlera e prezantuar në PFV ishte 162,224€, ndërsa sipas faturave përkatëse ishte 175,252€, duke rezultuar me diferencë prej 13,028€. Ndërsa në një rast, vlera e prezantuar në PFV ishte 1,175€, ndërsa sipas faturës ishte 1,049€, duke rezultuar me diferencë prej 125€.

Sipas zyrtarit përgjegjës në zyrën e tatimit në pronë, mospërputhjet ndërmjet vlerave të paraqitura në faturat e tatimit në pronë dhe atyre në llogaritë e arkëtueshme në (PFV) kanë ndodhur si rezultat i gabimeve në procesin e faturimit.

Ndikimi Mos-përputhjet ndërmjet faturave dhe llogarive të arkëtueshme dobësojnë besueshmërinë e procesit të faturimit, mund të ndikojnë në arkëtimin e të hyrave dhe të shkaktojnë ankesa nga tatimpaguesit. Gjithashtu, paraqesin rrezik potencial për ndikim në saktësinë e (PFV).

Rekomandimi A5 Kryetari, në bashkëpunim me Ministrinë e Financave, duhet të sigurojë rakordim të rregullt dhe të saktë ndërmjet faturave të tatimit në pronë dhe llogarive të arkëtueshme në (PFV), si dhe të forcojë kontrollet e brendshme për të parandaluar dhe korrigjuar me kohë çdo mospërputhje të identifikuar.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

3 Informacion i përmbledhur për planifikimin dhe realizimin e buxhetit

Në këtë kapitull kemi prezantuar një informacion të përmbledhur për burimet e fondeve buxhetore, shpenzimin e fondeve dhe të hyrave të mbledhura, sipas kategorive ekonomike. Kjo është ilustruar përmes tabelave dhe grafikëve të mëposhtëm:

Tabela 1. Shpenzimet sipas burimeve të fondeve buxhetore (në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti final ⁵	2025 Shpenzimet	2024 Shpenzimet	2023 Shpenzimet
Burimet e fondeve	23,284,922	25,503,000	24,707,488	25,077,790	21,129,662
Grante Qeveritare - Buxheti	20,883,498	21,767,374	21,457,871	20,823,286	18,726,949
Të bartura nga viti i kaluar	0	805,109	790,367	1,630,152	631,930
Të hyrat vetanake	2,401,424	2,401,424	2,272,150	2,166,578	1,386,174
Donacionet vendore	0	1,656	0	0	0
Donacionet e jashtme	0	527,437	187,099	457,774	384,609

Buxheti final është më i lartë se buxheti fillestar për 2,218,078€. Kjo rritje ishte nga grantet e Qeverisë prej 883,876€, bartja e të hyrave nga viti kalur prej 805,109€, si dhe donacioneve prej 529,093€.

Në vitin 2025 Komuna ka shpenzuar 97% të buxhetit final ose 24,707,488€, por duhet të theksojmë se gjatë vitit 2025, Komunës i janë ekzekutuar pagesa përmes vendimeve gjyqësore/përmbartimore në vlerë 3,082,897€ nga kategori të ndryshme ekonomike.


Tabela 2. Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike (në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti final	2025 Shpenzimet	2024 Shpenzimet	2023 Shpenzimet
Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike	23,284,922	25,503,000	24,707,488	25,077,790	21,129,662
Pagat dhe mëditjet	11,763,736	12,647,612	12,647,156	12,598,863	10,612,785
Mallrat dhe shërbimet	3,338,446	3,457,950	3,402,624	3,145,973	3,019,067
Komunalitë	557,600	616,713	582,610	657,205	339,610
Subvencionet dhe transferet	1,120,000	1,225,212	1,223,844	982,362	899,574
Investimet Kapitale	6,305,140	7,555,514	6,851,253	7,693,387	6,258,627
Rezervat	200,000	0	0	0	0

Shpjegimet për ndryshimet në kategoritë e buxhetit janë dhënë më poshtë:

- Buxheti final për paga dhe mëditje krahasuar me buxhetin fillestar ishte rritur për 883,876€. Kjo rritje ishte rezultat i vendimeve të Qeverisë, ndërsa realizimi i buxhetit final në këtë kategori ishte 100%;
- Në kategorinë e mallrave dhe shërbimeve, buxheti final krahasuar me atë fillestar ishte rritur për 119,504€. Kjo rritje ishte rezultat i bartjes së të hyrave vetjake nga viti paraprak dhe granteve të përcaktuara të donatorëve. Realizimi i buxhetit final në këtë kategori ishte 98%;
- Buxheti final për shpenzime komunale krahasuar me buxhetin fillestar ishte rritur për 59,113€. Kjo rritje ishte rezultat i bartjes së të hyrave vetjake nga viti paraprak, ndërsa ishin shpenzuar 94% e buxhetit;
- Buxheti final për subvencione dhe tranfere krahasuar me buxhetin fillestar ishte rritur për 105,212€. Kjo rritje ishte rezultat i bartjes së të hyrave vetjake nga viti paraprak. Realizimi i buxhetit final në këtë kategori ishte 100%; dhe
- Buxheti final për investime kapitale krahasuar me buxhetin fillestar ishte rritur për 1,250,374€. Kjo rritje ishte si rezultat i vendimeve të Qeverisë, i bartjes së të hyrave vetjake nga viti paraprak dhe grantet e përcaktuara të donatorëve. Realizimi i buxhetit final në këtë kategori ishte 91%, ku në këtë realizim reflekton edhe shuma 2,142,028€ e shpenzimeve përmes vendimeve gjyqësore të kryera për pagat jubilarë të shkaktuara nga kontrata kolektive.
- Buxheti final i planifikuar tek rezervat në vlerë 200,000€ me vendim të qeverisë ishte zvogëluar në tërësi 100%.

Grafiku 1. Shpenzimet sipas kategorive ekonomike për vitin 2025



Të hyrat vetjake të planifikuara për vitin 2025 ishin 2,401,424€, përderisa ishin realizuar 2,273,244€. Ato kanë të bëjnë me të hyrat nga tatimi në pronë, të hyrat nga lejet e ndërtimit, taksat administrative, të hyrat nga veprimtaritë biznesore, të hyrat nga qiraja etj. Po ashtu, komuna për vitin 2025, ka pranuar të hyra nga gjambat nga trafiku, gjambat e gjykatës dhe të hyrat nga agjencioni i pyjeve në vlerë totale prej 731,000€.

Tabela 3. Të hyrat (në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti final	2025 Pranimet	2024 Pranimet	2023 Pranimet
Totali i të hyrave	2,401,424	2,401,424	2,273,244	2,450,094	2,397,438
Të hyrat tatimore	1,208,356	1,208,356	837,150	544,389	1,023,369
Të hyrat jo tatimore	1,193,068	1,193,068	1,425,820	1,905,705	1,374,069
Të hyrat tjera	0	0	10,274		

4 Progresi në zbatimin e rekomandimeve

Raporti i auditimit për PVF-të të vitit 2024, ka rezultuar në 19 rekomandime. Komuna kishte përgatitur Planin e Veprimit ku paraqitet mënyra se si do t'i zbatoj rekomandimet e dhëna.

Deri në fund të auditimit tonë për vitin 2025, 11 rekomandime janë zbatuar, një rekomandim është zbatuar pjesërisht, ndërsa shtatë rekomandime nuk janë zbatuar ende, siç është paraqitur në Grafikon 2, më poshtë. Për një përshkrim më të plotë të rekomandimeve dhe mënyrën se si janë trajtuar ato, shihni në Tabelën 4 (ose Tabelën e rekomandimeve).

Grafiku 2. Progresi në zbatimin e rekomandimeve të vitit paraprak




Tabela 4. Përmbledhja e rekomandimeve të vitit paraprak

Nr	Fusha e Auditimit	Rekomandimet e vitit 2024	Veprimet e ndërmarra	Statusi
1.	Baza për opinion	Kryetari duhet të sigurojë se me rastin e përgatitjes së RVF, detyrimet kontingjente do të vlerësohen dhe paraqiten me vlera të sakta.	Nuk janë identifikuar raste të tilla për vitin 2025.	I zbatuar
2.	Baza për opinion	Kryetari duhet të sigurojë se zyra e financave do t'i prezantoj të gjitha obligimet e paguara në RVF.	Nuk janë identifikuar raste të tilla për vitin 2025.	I zbatuar
3.	Baza për konkluzion	Kryetari duhet të sigurojë se menaxhimi i kontratës nga menaxheri i projektit bëhet në pajtim me kërkesat ligjore, në mënyrë që kontrata publike kornizë me çmim njësi të realizohet në pajtueshmëri të plotë me peshën e përcaktuara në dosjen e tenderit.	Nuk janë identifikuar raste të tilla për vitin 2025.	I zbatuar
4.	Baza për konkluzion	Kryetari duhet të sigurojë që zyrtarët komunal të evidentohen rregullisht në regjistrin e vijueshmërisë për punë dhe kjo të dëshmohet përmes raporteve.	Nuk janë identifikuar raste të tilla për vitin 2025.	I zbatuar

5.	Baza për konkluzion	Kryetari duhet të sigurojë që janë ndërmarrë të gjitha veprimet e nevojshme në mënyrë që zyra e prokurimit zbaton kontratën e duhur ashtu siç e parasheh rregullativa ligjore.	Nuk janë identifikuar raste të tilla për vitin 2025.	I zbatuar
6.	Baza për konkluzion	Kryetari duhet të shtojë kontrollet e brendshme për tu siguruar regjistrimin e pasurisë nën 1,000€, në regjistrat kontabël të e-pasurive.	Nuk janë ndërmarrë veprimet e nevojshme për zbatim të këtij rekomandimi.	Nuk ka filluar zbatim
7.	Baza për konkluzion	Kryetari duhet të sigurojë, se për çdo ndryshim në shumat buxhetore të projekteve të aprovuara në ligjin e buxhetit, të marrë paraprakisht aprovimin nga Kuvendi Komunal.	Nuk janë ndërmarrë veprimet e nevojshme për zbatim të këtij rekomandimi.	Nuk ka filluar zbatim
8.	Baza për konkluzion	Kryetari duhet të sigurojë se zyra e prokurimit nuk do ta lëshoj dosjen e tenderit nëse në paramasën dhe paralogarinë specifikohet emri i prodhuesit.	Nuk janë identifikuar raste të tilla për vitin 2025.	I zbatuar
9.	Baza për konkluzion	Kryetari duhet të sigurojë arritjen e verifikimit të 20% të pronave të paluajtshme, në mënyrë që ndryshimet eventuale të pronave të integrohen në bazën e të dhënave për të reflektuar detyrimin e saktë tatimor.	Nuk janë ndërmarrë veprimet e nevojshme për zbatim të këtij rekomandimi.	Nuk ka filluar zbatim
10.	Të hyrat	Kryetari duhet të ndërmerr veprimet e nevojshme për të siguruar që baza e të dhënave të tatimit në pronë plotësohet me të gjithë numrat personal të tatimpaguesve.	Megjithëse, ishin ndërmarrë veprime për zbatim të këtij rekomandimi ende nuk është zbatuar në tërësi.	Pjesërisht i zbatuar
11.	Të hyrat	Kryetari duhet të sigurojë se raportet rregullta gjashtë (6) mujore të përmbajnë edhe raportimin e veçantë për monitorimin e realizimit të kontratave dhe përmbushjes së qëllimit të dhënies në shfrytëzim të pronave të paluajtshme.	Nuk janë ndërmarrë veprimet e nevojshme për zbatim të këtij rekomandimi.	Nuk ka filluar zbatim
12.	Subvencionet dhe transferet	Kryetari duhet të përmirësojë procesin e vlerësimit për dhënien e subvencioneve, duke siguruar që vetëm aplikantët që plotësojnë kriteret të përfitojnë nga subvencionimi.	Nuk janë identifikuar raste të tilla për vitin 2025.	I zbatuar
13.	Investimet kapitale	Kryetari duhet të sigurojë që janë ndërmarrë të gjitha veprimet që shpenzimet të planifikohen në ndarjet adekuate të buxhetit (apo të ridestinohen mjetet kur është e nevojshme dhe e mundshme), që pagesa dhe regjistrimi i shpenzimeve të bëhet sipas kodeve ekonomike adekuate.	Edhe në vitin 2025, kishte keqklasifikime të shpenzimeve nëpër kategoritë ekonomike.	Nuk ka filluar zbatim

14.	Investimet kapitale	Kryetari duhet të sigurojë forcimin e kontrolleve dhe monitoroj zbatimin e kërkesave ligjore, që me rastin e inicimit të procedurave të prokurimit për kontraktimin e punëve të sigurohet paraprakisht hartimi i projekteve ekzekutive në përputhje me nevojat dhe kërkesat e parashikuara.	Nga mostrat e testuara nuk kemi hasur raste të tilla.	I zbatuar
15.	Investimet kapitale	Kryetari duhet të sigurojë se zyra e prokurimit do t'i ndjek të gjithë hapat për procedimin e pagesave të përcaktuar me Rregullën Financiare për shpenzimin e parave publike.	Nga mostrat e testuara nuk kemi identifikuar raste të tilla.	I zbatuar
16.	Investimet kapitale	Kryetari duhet të sigurojë mekanizma adekuat në forcimin e kontrolleve në mbikëqyrjen e realizimit të projekteve, në mënyrë që ato të përfundohen me kohë sipas planit dinamik.	Nuk janë identifikuar raste të tilla për vitin 2025. Projektet e identifikuara në raportin e vitit paraprak kishin perfunduar gjatë vitit 2025.	I zbatuar
17.	Llogaritë e arkëtueshme	Kryetari duhet të sigurojë forcimin e kontrollit të brendshëm për menaxhimin e të arkëtueshmeve, si dhe rritjen e efikasitetit për arkëtimin e tyre. Poashtu të analizohen shkaktarët e rritjes së të arkëtueshmeve si dhe të krijojë strategji të mbledhjes së tyre, përfshirë dhe ndërmarrjen e veprimeve të nevojshme ligjore për inkasim.	Komuna nuk kishte ndermarreveprim e te mjaftueshme në implementimin e ketij rekomandimi.	Nuk ka filluar zbatimin
18.	Llogaritë e arkëtueshme	Kryetari duhet të sigurojë forcimin e kontrolleve të brendshme gjatë faturimit të tatimit në pronë dhe në rastet kur tatimi në pronë i ngarkohet pronave të cilat janë të lira me ligj të ndërmarrë veprimet e nevojshme për korrigjim dhe reflektim në RFV.	Nuk janë identifikuar raste të tilla për vitin 2025.	I zbatuar
19.	Obligimet e papaguara	Kryetari duhet të siguroj se hyrja në obligime bëhet vetëm pasi mjetet buxhetore të jenë zotuar paraprakisht, si dhe obligimet financiare ndaj kontraktuesve të paguhen brenda 30 ditëve nga data e pranimit të faturave në mënyrë që të shmangen pagesat shtesë të interesit nga vendimet gjyqësore/përmbartimore.	Nuk janë ndërmarrë veprimet e nevojshme për zbatim të këtij rekomandimi.	Nuk ka filluar zbatimin

Vlora Spanca, Auditore e Përgjithshme



Shkelqim Xhema, Drejtor i Auditimit



Arian Haxha, Udhëheqës i ekipit



Fatlinda Podvorica, Anëtare e ekipit





Albesa Tolaj, Anëtare e ekipit



Ejup Simnica, Anëtar i ekipit



Shtojca I: Letër konfirmimi

		REPUBLIKA E KOSOVËS REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVA KOMUNA E SUHAREKËS OPSTINA SUVA REKA-THE MUNICIPALITY OF SUHAREKA			
		25.05.2026			
REPUBLIKA E KOSOVËS - KOMUNA E SUHAREKËS REPUBLIC OF KOSOVA - THE MUNICIPALITY OF SUHAREKA					
MAPË ME KORËZIM-PRILJENO-RECEIVED					
Njësi e Org. / Org. Unit	Nr. / Number	Shtesa / Annex	Vlera / Value		
01/d6	23720				

LETËR E KONFIRMIMIT

Për pajtueshmërinë me gjetjet e Auditorit të Përgjithshëm për vitin 2025 dhe për zbatimin e rekomandimeve

Për: Zyrën e Kombëtare të Auditimit

Të nderuar,

REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIC OF KOSOVA ZYRA KOMBËTARE E AUDITIMIT NACIONALNA KANCELARIJA REVIZIJE / NATIONAL AUDIT OFFICE			
DATË PËR SHËRIMIN / DATE FOR RECEIPT: 25-05-2026			
Nr. Org. / Org. No.	Nr. Klasif. / Class. Code	Nr. Prot. / Prot. No.	Nr. Tëpër / Br. Stranica / No. Pages
04	47	834	1

Përmes kësaj shkrese, konfirmoj se:

- kam pranuar draft raportin e Zyrës Kombëtare të Auditimit për auditimin e pasqyrave financiare vjetore të Komunës së Suharekës, për vitin 2025.
- pajtohem me gjetjet dhe rekomandimet dhe nuk kam ndonjë koment për përmbajtjen e Raportit;
- brenda 30 ditëve nga pranimi i Raportit final, do t'ju dorëzoj një plan të veprimit për zbatimin e rekomandimeve, i cili do të përfshijë afatet kohore dhe stafin përgjegjës për zbatimin e tyre.

z. Bali Muharremaj,

Kryetar i Komunës së Suharekës

Data: 25/05/2026, Suharekë



Shtojca II: Shpjegim lidhur me llojet e të ndryshme të opinionëve të aplikuara nga ZKA dhe pjesëve të tjera të Raportit të Auditimit

Raporti i auditorit për pasqyrat financiare⁶ duhet të përmbajë një opinion për pasqyrat financiare, bazuar në përfundimet e nxjerra nga dëshmitë e marra gjatë auditimit. Kur auditimi kryhet për të vlerësuar gjithashtu përputhjen me legjislacionin dhe rregulloret e tjera, auditorët kanë një përgjegjësi shtesë për të raportuar për pajtueshmërinë me autoritetet⁷, duke rezultuar me konkluzion mbi pajtueshmërinë.

Për të arritur në përfundimin se një opinion mbi pasqyrat financiare është i modifikuar ose i pa modifikuar, një auditor duhet të sigurohet që rezultatet e auditimit përfshijnë, apo jo, keq-deklarim (e) material(e) ose të përhapur(a), apo të tillë(a) të mundshëm(me), të supozuar në rast kufizimi të fushëveprimit.

Keq-deklarimi është një ndryshim mes shumës së raportuar, klasifikimit, prezantimit ose zbulimit të një zëri të pasqyrës financiare dhe sasisë, klasifikimit, prezantimit ose zbulimit që kërkohet që zëri të jetë në përputhje me kornizën e raportimit financiar në fuqi. Keq-deklarimet mund të vijnë nga gabimi ose mashtrimi.

(shkëputur nga SNISA 200)

Forma e opinionit

Opinion i pa-modifikuar

Formulohet kur nuk janë zbuluar keq-deklarime ose mos-pajtueshmëri; kur janë zbuluar keq-deklarime ose mos-pajtueshmëri, qoftë një i vetëm apo një grumbull, por që nuk është i barabartë me ose nuk e tejkalon nivelin e materialitetit për pasqyrat financiare si tërësi; ose kur keq-deklarimi(et) dhe/ose mos-pajtueshmëria e zbuluar brenda një klase të caktuar transaksionesh nuk është e barabartë me ose e tejkalon nivelin e materialitetit më të ulët të vendosur për këtë klasë të transaksioneve. Formulohet gjithashtu nëse nuk ka kufizim të fushëveprimit ose kur kufizimi i fushëveprimit nuk mund të shpie në shmangie të keq-deklarimit(eve) material(e) dhe/ose mos-pajtueshmërisë(ve).

Kufizimi i fushëveprimit ndodh kur një auditor nuk është në gjendje të marrë dëshmi të mjaftueshme auditimi për të arritur në përfundimin se pasqyrat financiare në tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale.

Auditori duhet të japë **opinion të pa-modifikuar** nëse arrin në përfundimin se pasqyrat financiare janë përgatitur, në të gjitha aspektet materiale, në pajtim me kornizën e zbatueshme financiare.

Modifikimi i opinionit në raportin e auditorit

Auditori duhet të modifikojë opinionin në raportin e auditorit nëse konstatohet se, bazuar në dëshmitë e marra nga auditimi, pasqyrat financiare në tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale dhe/ose mos-pajtueshmëri, ose nuk është në gjendje të sigurojë prova të mjaftueshme të auditimit për të arritur në përfundimin se pasqyrat financiare në tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale dhe/ose mos-pajtueshmëri..

Opinionin i modifikuar mund të jetë:

- I kualifikuar,
- I kundërt, ose
- Mohim opinionin

Opinionin i kualifikuar

Formulohet kur janë zbuluar keq-deklarime dhe/ose mos-pajtueshmëri, qoftë një i vetëm apo një grumbull, që janë të barabartë me ose e tejkalojnë nivelin e materialitetit për pasqyrat financiare si tërësi; ose kur keq-deklarimi dhe/ose mos-pajtueshmëria e zbuluar brenda një klase të caktuar transaksionesh është i barabartë me ose tejkalon nivelin e materialitetit më të ulët të vendosur për këtë klasë të transaksioneve. Formulohet gjithashtu nëse ka kufizim të fushëveprimit, i cili mund të mos shpie në shmangie të keq-deklarimit(eve) material(e).

Opinionin i kundërt

Formulohet kur janë zbuluar keq-deklarime dhe/ose mos-pajtueshmëri, qoftë një i vetëm apo një grumbull, që tejkalon në mënyrë të përhapur nivelin e materialitetit për pasqyrat financiare si tërësi; ose kur keq-deklarimet dhe/ose mos-pajtueshmëritë e zbuluara brenda një klase të caktuar transaksionesh e tejkalojnë në mënyrë të përhapur nivelin e materialitetit më të ulët të vendosur për këtë klasë të transaksioneve.

“E përhapur” është term që përdoret, në kontekstin e keq-deklarimeve dhe/ose mos-pajtueshmërive, për të përshkruar efektet e keq-deklarimeve dhe/ose mos-pajtueshmërisë në pasqyrat financiare; ose efektet e mundshme në pasqyrat financiare të keq-deklarimeve dhe/ose mos-pajtueshmërisë, nëse ka të tilla, që nuk zbulohen për shkak të pamundësisë për të marrë dëshmi të mjaftueshme e të duhura të auditimit. Efektet e përhapura në pasqyrat financiare janë ato që, sipas gjykimit të auditorit::

- a) Nuk kufizohen vetëm në elemente, llogari ose zëra të veçantë të pasqyrave financiare;
- b) Por nëse kufizohen si të tilla, përfaqësojnë ose mund të përfaqësojnë një pjesë të konsiderueshme të pasqyrave financiare; ose
- c) Për sa i përket shpalosjeve, janë thelbësore që përdoruesit të kuptojnë pasqyrat financiare.

Mohim i opinionit

Formulohet kur kufizimi i fushëveprimit, d.m.th. kur pamundësia për të siguruar prova të mjaftueshme të përshtatshme të auditimit, është i natyrës materiale dhe pervazive.

Paragrafët e Theksimit të Çështjes dhe paragrafët e Çështjeve të Tjera në raportin e auditorit

Nëse auditori e konsideron të nevojshme të tërheqë vëmendjen e përdoruesve në një çështje të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila është sa e rëndësishme aq edhe thelbësore që ata të kuptojnë pasqyrat financiare, por ka dëshmi të mjaftueshme e të përshtatshme se çështja nuk përmban keq-deklarime materiale në pasqyrat financiare, auditori duhet të përfshijë paragrafin e Theksimit të çështjes në raportin e tij. Paragrafi për Theksimin e Çështjes duhet t'i referohet vetëm informacionit të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare.

Paragrafi i theksimit të çështjes duhet:

- të përfshihet menjëherë pas opinionit;
- të ketë titullin 'theksim i çështjes' ose ndonjë titull tjetër të përshtatshëm;
- të përmbajë një referencë të qartë ndaj çështjes që theksohet dhe të tregojë se në ç'pjesë të pasqyrave financiare mund të gjenden shpalosjet relevante që e përshkruajnë plotësisht çështjen; dhe
- të tregojë se opinionit i auditimit nuk është modifikuar për sa i përket çështjes të theksuar.

Nëse auditori e konsideron të nevojshme të komunikojë një çështje, përveç atyre që janë paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila, në gjykimin e auditorit, është e rëndësishme për përdoruesit në mënyrë që të kuptojnë auditimin, përgjegjësitë e auditorit apo raportin e auditimit, dhe me kusht që kjo nuk është e ndaluar me ligj ose rregullore, duhet të përpilohet një paragraf me titullin "Çështje të tjetra", apo ndonjë titull tjetër të përshtatshëm. Ky paragraf duhet të paraqitet menjëherë pas opinionit dhe pas çdo paragrafi të Theksimit të çështjes.

Shënimet fundore

- ¹ Pajtueshmëria me autoritetet - pajtueshmëria me të gjitha ligjet, rregullat, rregulloret, standardet dhe praktikat e mira relevante në sektorin publik
- ² Raportet tjera janë kërkesë e nenit 8 të së Rregullores 01/2017 për Raportim Vjetor Financiar
- ³ Kolektivisht të referuara si pajtueshmëri me autoritetet
- ⁴ Çështja A dhe Rekomandimi A - nënkupton çështjet dhe rekomandimet e reja
Çështja B dhe Rekomandimi B - nënkupton çështjet dhe rekomandimet e përsëritura
Çështja C dhe Rekomandimi C- nënkupton çështjet dhe rekomandimet pjesërisht të përsëritura.
- ⁵ Buxheti Final - buxheti i aprovuar nga Kuvendi i përshtatur më pas nga Ministria e Financave
- ⁶ Pasqyrat financiare në sektorin publik përfshijnë po ashtu edhe pasqyrën(at) e ekzekutimit të buxhetit
- ⁷ Pajtueshmëria me autoritetet: pajtueshmëria me ligjet, rregulloret, standardet, apo praktikat e mira.